

V E N D I M
Nr.214, datë 28.4.1999

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLERAVE MESATARE TË TREGUT TË LIRË TË
BANESAVE DHE TË KOEFICIENTIT "K"**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kostoja mesatare, në shkallë republike, e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 1998 është 27878 (njëzeteshtatë mijë e tetëqindeshtatëdhjetëetë) lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Vlera mesatare, në shkallë rrethi, e apartamenteve tip të tregut të lirë të banesave për vitin 1998, ka qenë sipas tabelës, e cila ii bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vlerat e koeficientit "k", të nenit 3, të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" është sipas tabelës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pikat 1, 2 dhe 3 të përdoren nga Banka e Kursimeve gjatë vitit 1999, në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" dhe nga EKB-ja, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 90, dtë 25.2.1999 "Për vlerën e shitjes së apartamenteve, të financuara me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave".

5. Ngarkohet INSTAT, që, brenda datës 31.5.1999, të sigurojë të dhënat për vlerat mesatare të tregut të lirë të banesave për rrethet Tiranë, Mirditë, Sarandë, Tropojë, Delvinë, Malësi e Madhe.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

TË DHËNA PËR TREGUN E LIRË TË APARTAMENTEVE PËR VITIN 1998

Nr.	Rrethet	Mijë lekë/m ² sip shfrytëzimi
1.	Berat	21.8
2.	Bulqizë	11.23
3.	Delvinë	
4.	Devoll	21.2
5.	Dibër	15.77
6.	Durrës	27.48
7.	Elbasan	23.63
8.	Fier	27.78
9.	Gramsh	11.07
10.	Gjirokastrë	30.46
11.	Has	15.30
12.	Kavajë	21.77

13.	Kolonjë	10.37
14.	Korçë	18.74
15.	Krujë	18.38
16.	Kuçovë	18.95
17.	Kukës	15.63
18.	Kurbin	23.1
19.	Lezhë	24.51
20.	Librazhd	20.61
21.	Lushnjë	11.42
22.	Malësi e Madhe	
23.	Mallakastër	28.8
24.	Mat	12.34
25.	Mirditë	
26.	Peqin	26.84
27.	Përmet	15.13
28.	Pogradec	21.97
29.	Pukë	19.04
30.	Sarandë	
31.	Skrapar	10.71
32.	Shkodër	23.4
33.	Tepelenë	14.47
34.	Tiranë	
35.	Tropojë	
36.	Vlorë	27.47

VLEFTAT E KOEFICIENTIT “K”,
SIPAS NENIT 3 TË LIGJIT NR. 8030, DT. 15.11.1995
“PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA”

Nr.	Rrethet	Vleftat e koeficientit “k”
1.	Berat	0.78
2.	Bulqizë	0.40
3.	Delvinë	
4.	Devoll	0.77
5.	Dibër	0.57
6.	Durrës	0.98
7.	Elbasan	0.85
8.	Fier	0.99
9.	Gramsh	0.40
10.	Gjirokastër	1.00
11.	Has	0.55
12.	Kavajë	0.78
13.	Kolonjë	0.37
14.	Korçë	0.67
15.	Krujë	0.66
16.	Kuçovë	0.68
17.	Kukës	0.56

18.	Kurbin	0.83
19.	Lezhë	0.88
20.	Librazhd	0.74
21.	Lushnjë	0.41
22.	Malësi e Madhe	
23.	Mallakastër	1.00
24.	Mat	0.44
25.	Mirditë	
26.	Peqin	0.96
27.	Përmet	0.54
28.	Pogradec	0.79
29.	Pukë	0.69
30.	Sarandë	
31.	Skrapar	0.38
32.	Shkodër	0.84
33.	Tepelenë	0.52
34.	Tiranë	
35.	Tropojë	
36.	Vlorë	0.99